



**A është vërtetë më mirë të qeverisin teknokratët?  
Zgjedhjet paraprake në Francë forcojnë demokracinë  
Ndërkohë që perspektiva europiane venitet, Turqia shikon nga lindja**

# EUROSPEAK

Buletin i Lëvizjes Europiane në Shqipëri

Nr.5, Tetor - Nëntor 2011

## Speciale

### 12 detyrat e Shqipërisë. Ku jemi sot?



Komisioni European publikoi në 12 tetor 2011 Paketën e Zgjerimit për periudhën 2010-2011, në të cilën përfshihen Strategjia e Zgjerimit dhe Raportet e Progresit për vendet e rajonit të Ballkanit Perëndimor. Në Raportin e tij të Progresit për Shqipërinë për vitin 2011, Komisioni bën për së dyti një vlerësim negativ

për gatishmërinë e vendit tonë drejt marrjes së statusit të vendit kandidat. Ky vlerësim nuk erdhi si një rrufe në qiell të kaltër. Vjet, Komisioni European publikoi Opinionin për aplikimin e Shqipërisë për anëtarësim në Bashkimin European. Në Raportin Analitik që shoqëron Opinionin, një dokument i plotë dhe i detajuar, Komisioni bëri një skanim të gatishmërisë së Shqipërisë për plotësimin e kriterëve të Kopenhagenit dhe arriti në përfundimin se Shqipëria duhej të përmbushte

...vijon në faqen 2 >>

### Kriza ekonomike: Një problem (thuaje) pa zgjidhje...



Foto: shutterstock.com

Kriza e borxheve tashmë ka përpirë në humnerën e saj dy qeveri, atë të Papandreut në Greqi dhe të Berlusconi në Itali. Tregjet financiare janë tronditur disa herë në pak javë dhe samiti G20 duket se ka dështuar. Ndërkohë, shumë kryeqytete të botës vlojnë nga protestat. Në brendësi, një analizë e pasojave ekonomike dhe politike të krizës.

*Fareed Zakaria, analist i mirënjohur ndërkombëtar shprehet skeptik për aftësitë e Greqisë për rimëkëmbje ekonomike, por gjithsesi mbetet optimist për të ardhmen e Europës:*

Është ironike që Greqia - një ekonomi e vogël që përbën vetëm 2.2% të Eurozonës dhe s'është as mes 25 ekonomive më të mëdha në botë - ka prodhuar aq shumë trazira. Por kjo ka të bëjë me një të metë themelore në hartimin e eurozonës. Europa ka krijuar një monedhë të vetme, pa koordinimin e politikave fiskale të përshtatshme.

...vijon në faqen 5 >>

### Trafiku si tregues i gatishmërisë së Shqipërisë për tu anëtarësuar në BE



Ambasadori i Mbretërisë së Danimarkës, Karsten Ankaer Jensen

Sot, përsëri do të flas për temën time të preferuar: trafikun. Për shumicën e të huajve, trafiku shqiptar është e para gjë që shohin mes problemeve të integritimit të Shqipërisë në BE.

Sigurisht, që trafiku është thjesht një nga gjërat që tregon se si funksionon një shoqëri. Megjithatë, ai tregon shumë se si njerëzit ndërveprojnë e bashkëpunojnë. Në terma shumë të dukshëm e konkretë, ai tregon aftësinë e shoqërisë për të funksionuar si një shoqëri.

Pra trafiku është një mikrokozmos i shoqërisë, si një e tërë, edhe për marrëdhëniet pakufizim gjithmonë e më kërkuese që harton BE-ja.

Mendoj se për shumë vizitorë të huaj, gjendja e

...vijon në faqen 4 >>



## 12 detyrat e Shqipërisë. Ku jemi sot?

...vijon nga faqja 1 >>>



Karikatura: Rael Hoxha

12 përparësitë e identifikuara në Opinion, përpara se të merrte dritën e gjelbër për statusin e vendit kandidat dhe fillimin e bisedimeve për anëtarësim.

12 përparësitë rrokin fushat më të rëndësishme përnjë shoqëri demokratike si: vendosja e dialogut politik dhe funksionimi i duhur i Kuvendit, reforma zgjedhore dhe mbajtja e zgjedhjeve në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe europiane, funksionimi i pavarur i sistemit të drejtësisë, rezultate konkrete në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, respektimi i të drejtave pronësore, respektimi i të drejtave të njeriut dhe grupeve vulnerabël, përmirësimi i trajtimit të personave në rajonet e policisë, para-burgimit dhe burgje.

Raporti i Progresit për vitin 2011 bën një vlerësim të detajuar të përmbushjes nga Shqipëria të 12 përparësive, duke arritur në konkluzionin se ende nuk mund të propozojë statusin kandidat për vendin tonë. Në mënyrë që të përparohet në këtë proces, Shqipëria duhet të japë prova konkrete të adresimit të 12 përparësive para takimit të Këshillit Europian që do të mbahet në dhjetor 2011, ku Vendet Anëtare të BE-së do të miratojnë konkluzionet për ecurinë e vendeve të Ballkanit Perëndimor. Në rast se Shqipëria përfshihet në kursin e reformave të vërteta, Vendet Anëtare të BE-së mund të njohin progresin e Shqipërisë, e t'i kërkojnë Komisionit

Europian një vlerësim, pa pritur vjeshtën e vitit 2012. Sipas këtij skenari hipotetik, Komisioni mund të kryente vlerësimin dhe mund të rekomandonte akordimin e statusit të vendit kandidat për Shqipërinë, në rast të përmbushjes së përparësive të identifikuara, në pranverën e vitit të ardhshëm.

Nga këto reflektime të publikuara në tetor në punimin e EMA-s **"12 detyrat e Shqipërisë. Ku jemi sot?"** mori shkas forumi i mbajtur më 15 nëntor 2011, i cili mbledhi Ambasadorët e tre shteteve anëtare të BE-së që përfaqësojnë Presidencën e kaluar (hungareze), aktuale (polake) dhe atë të ardhshme (daneze) të BE-së si dhe analistë, akademikë, përfaqësues të institucioneve shtetërore, studentë, etj. Në fokus të aktivitetit ishin analizat dhe diskutimet mbi situatën aktuale me të cilën po përballet Shqipëria në rrugën e saj drejt BE-së.

Gjatë këtij takimi, Ambasadori i Republikës së Hungarisë në Shqipëri Z. Janos Huszar u ndal në mënyrë të veçantë tek shembujt që Shqipërisë i vijnë nga vendet e rajonit, ku ai veçoi Kroacinë dhe Serbinë. Sipas tij Shqipëria duhet t'i referohet Kroacisë, rruga e secilës është një histori suksesi. Gjithashtu, ai theksoi rëndësinë e përmirësimit të imazhit të vendit lidhur me angazhimet e ndërmarra në kuadër të këtij procesi. Ambasadorja Polake Znj. Irena Tatarzyńska, paraqiti këndvështrimin e Presidencës Polake të BE-së lidhur me dialogun e brendshëm politik si kusht për anëtarësim në BE. Duke iu referuar përvojës së vendit të saj, ajo theksoi se ishte pikërisht falë vullnetit dhe dialogut të qëndrueshëm politik mes palëve që diskutimi publik në Poloni u zhvendos nga: "në qoftë se...", në "kur..." do të anëtarësohemi.

Ambasadori i Mbretërisë së Danimarkës në Shqipëri Z. Karsten Ankjaer Jensen, përdori

...vijon nga faqja 2 >>

simbolikën e kaosit të qarkullimit rrugor në vend, për të treguar mënyrën e funksionimit dhe organizmit të shoqërisë shqiptare. Ai theksoi se një përgjegjësi të veçantë në ndryshimin e

sjelljes apo të qëndrimit të shoqërisë e kanë elitat politike. Fjalën e plotë të Ambasadorit Jensen mund ta lexoni në editorialin e këtij numri.

## Çfarë solli vjeshta e 2011-ës për perspektivën e anëtarësimit të Ballkanit Perëndimor në BE?

Në 12 Tetor 2011, Komisioneri për Zgjerimin Stefan Fule prezantoi Paketën e Zgjerimit për periudhën 2010 – 2011 për vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Islandën, e cila përmban vizionin e Komisionit European për politikën e zgjerimit, sikundër një vlerësim për secilin vend të rajonit mbi shkallën e progresit të bërë drejt rrugëtimit European. Më konkretisht, progresin për secilin vend të rajonit e gjeni të sintetizuar në tabelën e mëposhtme.

Vendi	Zhvillimet gjatë 2011	Vlerësimi i KE-së
<b>Vende Kandidate për Anëtarësim në BE</b>		
<b>Kroacia</b>	Vendi ka dëshmuar progres dhe angazhim maksimal në përmbushjen e kriterëve të anëtarësimit. Mbyllja e kapitujve më të vështirë si gjyqësori, të drejtat themelore dhe politikat e konkurrencës, shënoi edhe finalizimin me sukses të negociatave për anëtarësim në qershor të 2011.	<i>Pozitiv.</i> Komisioni propozon datën 1 Korrik 2013, si datën e anëtarësimit të Kroacisë në BE.
<b>Maqedonia</b>	Problemi ende i pa zgjidhur midis Maqedonisë dhe Greqisë lidhur me çështjen e emrit mbetet pengesa kryesore për hapjen e negociatave për anëtarësim me Maqedoninë.	<i>Pozitiv.</i> Komisioni ripërsërit propozimin e tij për hapjen e negociatave me Maqedoninë.
<b>Mal i Zi</b>	Mali i Zi gëzon statusin e vendit kandidat për në BE që prej dhjetorit 2010. Vendi ka dëshmuar progres në adresimin e 7 prioritetëve të identifikuar një vit më parë në Opinionin e KE mbi aplikimin për anëtarësim në BE të Malit të Zi si kusht për hapjen e negociatave.	<i>Pozitiv.</i> Komisioni propozoi hapjen e negociatave për anëtarësim me Malin e Zi.
<b>Vende Kandidate potenciale për Anëtarësim në BE</b>		
<b>Serbi</b>	Komisioni dha një vlerësim pozitiv lidhur me aplikimin e Serbisë për anëtarësim në BE më 22 dhjetor 2009. Vendi ka bërë progres në përmbushjen e reformave dhe veçanërisht në bashkëpunimin me Tribunalin e Hagës.	<i>Pozitiv.</i> Komisioni propozon që Serbisë të jepet statusi i vendit kandidat. Gjithashtu, negociatat për anëtarësim në BE rekomandohen të hapen me ndërmarrjen nga Serbia të hapave të mëtejshëm për të normalizuar marrëdhëniet me Kosovën.
<b>Shqipëria</b>	Ngërçi politik që prej zgjedhjeve të përgjithshme të Majit 2009, ka penguar progresin e vendit lidhur me kryerjen e reformave. Vendi nuk ka arritur të adresojë pothuajse asnjë nga 12 prioritetet e identifikuar në Opinionin e KE për aplikimin e Shqipërisë për anëtarësim në BE.	<i>Negativ.</i> Komisioni nuk propozoi dhënie të statusit të vendit kandidat e as hapjen e negociatave për anëtarësim.
<b>Kosovë</b>	Axhenda e reformave ka njohur progres të kufizuar për shkak të problematikave dhe tejzgjatjes së procesit zgjedhor, si dhe situatës së tensionuar në veriun e Kosovës.	<i>Pozitiv/Negativ.</i> Komisioni rekomandon fillimin e një dialogu me Kosovën në kuadër të garantimit të shtetit të së drejtës si dhe nisjen e dialogut për liberalizimit e vizave nga fundi i vitit.
<b>Bosnje Hercegovina</b>	Vendi karakterizohet nga një bllokim i vazhdueshëm politik dhe institucional, i cili ka penguar funksionimin normal të shtetit dhe dëmtuar axhendën e reformave në kuadër të integrimi European.	<i>Negativ.</i> Negociatat për nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit ende nuk mund të nisnin.

Stafi i EuroSpeak, nëntor 2011



...vijon nga faqja 1 >>

trafikut shqiptar shërben si një tregues “sipërfaqësor” për gadishmërinë e vendit tuaj për t’u bërë pjesë e komunitetit të Bashkimit European.

Ajo çka ata përjetojnë nuk është inkurajuese! Një sjellje që ndeshet shpesh është: nevojat e mia janë përpara gjithçkaje, pavarësisht pasojave që mund të kenë tek të tjerët.

Dikush ndjen nevojën për një kafe, dhe duket se e sheh të përshtatshme të parkojë makinën e tij apo të saj në rresht të dytë apo të tretë duke shkatërruar rrjedhën e trafikut, duke shkaktuar irritim, dhe kohë të humbur, për ndoshta mijëra të tjerë, që përpiqen të shkojnë nga një vend në tjetrin. Një kafe kjo me të vërtetë e shtrenjtë për shoqërinë!

Por, drejtues makinash të shkujdesur mund të gjeni në të gjitha vendet. Ndryshimi qëndron se në shumicën e vendeve me të cilat Shqipëria synon të bashkohet, të paktë janë ata që do të paraqisnin një sjellje të tillë, sepse e dinë që ajo është e gabuar dhe mbart një ndëshkim.

Kjo ende nuk ndodh në Shqipëri, pavarësisht, pranisë së lartë të policisë. Mbase është edhe më dekurajuese kur çdo ditë shihni, ata që duhet të ishin mbrojtësit më të lartë të ligjit, policët, politikanët, dhe ministra qeveritarë, apo zyrtarë të shfaqin sjellje të ngajshme rëndom.

“Përse duhet që ne t’i bindemi ligjit, kur udhëheqësit tanë, qartësisht nuk e bëjnë këtë?” është një pyetje që mu bë nga një kamarier, dhe shumë sinqerisht, është një pyetje e mirë. Udhëheqja nuk është vetëm t’i tregosh njerëzve se çfarë duhet të bëjnë. Është t’ua demonstrosh atë. Të jesh shembulli për tu ndjekur nga të tjerët.

Fatkeqësisht shumë herë shembujt e dhënë nga qeveria, politikanët, të pushtetshmit, ruajtësit e ligjit, dhe rendit, janë të atij lloji që në fund të fundit, nuk e drejtojnë këtë vend drejt BE-së.

Zor se mund të fajësoni një shqiptar të thjeshtë, për marrjen e mesazhit të gabuar, për ndjekjen e shembullit të keq. Ajo çka mund të themi ne si ndërkombëtarë, dhe që duhet ta themi, është se duke ndjekur këto shembuj, nuk e çoni Shqipërinë gjëkund! Vetëm e mbyllni kombin në të kaluarën e tij. Dhe të shkuarës Shqipëria duhet t’ia ketë treguar derën 20 vitet e fundit.

Përsa kohë që ta lejonit këtë pakicë t’ju dëmtojë ju dhe pjesën tjetër të shoqërisë, taktikisht po pranoni që perspektiva europiane do të vazhdojë të mbetet një ëndërr e largët për të gjithë.

Sigurisht që një përgjegjësi e vecantë për ndryshimin e sjelljes apo të qëndrimit qëndron te elitat e pushtetshme sepse ato janë si kullat e farit drejt të cilave të gjithë shikojnë për tu drejtuar. Për mirë a për keq, ato e tregojnë drejtimin. Megjithatë ky nuk duhet të merret si një justifikim. Është zgjedhje individuale për secilin shqiptar se në ç’drejtim e lejojnë veten të udhëhiqen. Dhe shumë sinqerisht në ditët e sotme dhe kohën e internetit, wikileaks, etj, është e pamundur të bësh të paditurin.

Historia e Shqipërisë e gjatë 20 viteve të fundit duket si një përsëritje e legjendës së kalasë së Rozafës, në Shkodër. Muret ndërtoheshin gjatë ditës, për tu rrëzuar gjatë natës. Por ndryshe nga sa ndodhi në legjendën e Rozafës, asnjë nuk duket të ketë vullnetin për të bërë një sakrificë që muret të qëndrojnë.

Sigurisht që përfundimi i pashmangshëm, që Europa duhet të nxjerrë dhe që e nxorri, është se Shqipëria nuk është gati. As për të qenë një kandidat për t’u anëtarësuar. Lajmi i mirë është se sjellja dhe zakonet e këqia, mund të ndryshojnë. Parimisht, nga një moment te tjetri. Është çështje vullneti. Vullneti për të ndryshuar. Nëse populli shqiptar tregon vullnetin dhe kurajën për të kërkuar ndryshim, ky do të mund të ishte hapi më i madh drejt anëtarësimit në BE. Sikurse e kam thënë në shumë raste të tjera, kam bindjen e fortë, se vrulli dhe zelli i popullit shqiptar, shpejt do të kujdeset për të tjerat.

Ndoshta, politikanët po fillojnë ta kuptojnë se çfarë rrezikohet. Dëgjoj se vitet e kaluara të ngërcit politik tashmë do bëhen histori e shkuar. Nëse është e vërtetë, kjo me të vërtetë që përbën lajm të mirë. Mund të jetë një hap i vogël i pasigurtë përpara, por çdo udhëtim fillon me hapin e parë. Le të shpresojmë që politikanët të vazhdojnë të ecin. Por edhe që së shpejti do të fillojnë të vrapojnë.

Treni drejt Europës po nis. Populli shqiptar duhet të jetë në të.

*Shkëputur nga fjala e Ambasadorit të Mbretërisë së Danimarkës Karsten Ankjaer Jensen, mbajtur më 15 nëntor 2011 në forumin e organizuar nga EMA’s mbi 12 Detyrat e Shqipërisë për integrimin në BE.*

## Kriza Ekonomike: Një problem (thujtë) pa zgjidhje...

...vijon nga faqja 1 >>

Ekonomi shumë konkurruese si ajo Gjermane u bashkuan me ekonomi jo-konkurruese si Greqia. Sipas Zakaria-s, Greqia ndoshta nuk është e shpëtueshme. Ajo ka një borxh shumë të madh dhe në thelb, nuk është një ekonomi konkurruese. Nuk prodhon asgjë që të mund të thithet në treg. Ndërkohë, kjo nuk është e vërtetë për ekonomi si e Spanjës apo Irlandës. Ato kanë ekonomi mjaft dinamike edhe pse të goditura nga kriza financiare. Pra, pyetja e vërtetë është nëse ekziston ndonjë mënyrë për ta rrethuar Greqinë nga pjesa tjetër e Europës. Ndoshta atëherë do të kishte një skenar në të cilin gjermanët të garantonin mbulimin e të gjithë borxhit të mbetur. E vërteta është që Greqia ka falimentuar disa herë më parë. Që nga pavarësia e saj në vitin 1830, Greqia ka qenë e falimentuar për rreth 50% të kohës së ekzistencës së saj si vend i pavarur. Dallimi është se tani gjermanët janë të gatshëm të shpëtojnë grekët. Kjo është risia e vetme.

Nuk jam i sigurt nëse Europa do t'i mbijetojë gjithë kësaj rrëmuje. Por hamendësimi im më i mirë është se, përfundimisht, zgjidhja do të vijë nga Banka Qendrore Europiane (BQE). Ashtu si Rezerva Federale e SHBA-së, Banka Qendrore Europiane ka shumë fuqi dhe liri veprimi. Sapo të fillojë të garantojë apo blejë lloje të ndryshme borxhesh, do të jetë në gjendje të stabilizojë euron. Dhe kjo është edhe politikisht më e pëlqyeshme.

*CNN, 4 nëntor 2011*

### A është vërtetë më mirë të qeverisin teknokratët?

Në fillim tregjet i përshëndetën, pastaj shfaqën shqetësim mbi emërimin e ekonomistëve akademikë si kryeministra të Greqisë dhe Italisë.

Në Europë ndërkohë, kryeministrat dhe ministrat teknokratë duken e vetmja rrugëdalje për të mbajtur nën kontroll financat dhe çuar përpara reformat ekonomike. Italia jo vetëm që ka një profesor ekonomie si kryeministër (Mario Monti), por ka pranuar gjithashtu që FMN-ja të shqyrtojë programin e saj të reformës. Greqia ka pranuar që një trojkë e përbërë nga FMN-ja, Banka Qendrore

Europiane dhe Komisioni European të mbikëqyrë masat e saj anti-krizë. Po kështu kanë bërë dhe Irlanda e Portugalia.

Zakonisht, qeveritë demokratike kërkojnë mbështetje publike për politikën që ndjekin dhe kanë mënyra të ndryshme për të mobilizuar mbështetësit, ndër të cilat zgjedhjet janë më të rëndësishmet. Por ka arsye të veçanta pse proceset e zakonshme të mobilizimit publik nuk duhet të përdoren në këtë moment. Në vendet e Eurozonës, monedha në vetvete është e papëlqyer. Sipas një sondazhi të fundit të German Marshall Fund, 53% e qytetarëve në vendet që përdorin euron mendojnë se monedha e vetme ka qenë e dëmshme për ekonominë e tyre kombëtare, kundrejt vetëm 40% që mendojnë se ajo ka qenë e dobishme. Është e vështirë të marrësh mbështetjen e publikut për programe të ashpra shkurtimesh edhe në kohë më të mira. Edhe më e vështirë të kërkes mbështetjen e tyre për një monedhë që nuk u pëlqen. S'është çudi që politikanët kanë thirrur aktorë nga jashtë për zgjidhje dhe tani kanë kë të fajësojnë për masat shtrënguese kundër krizës që po imponohen.

Amerika dhe Europa kanë një problem të përbashkët: kriza ekonomike dhe financiare i ka diskredituar politikanët e zakonshëm. E djathta shihet gjerësisht si partia e të pasurve, shumë afër me bankierët jopopullorë, dhe përgjegjëse për liberalizimi financiar të viteve 1980 i cili, për disa, ishte burimi i të gjitha telasheve. Por e majta, e cila mund të pritet të ketë përfituar nga një situatë e vështirë për kapitalizmin, nuk është një situatë më të mirë. Qeveritë e qendrës së majtë, të paktën në Britani dhe Amerikë, janë të kompromentuara dhe perceptohen si jo në gjendje të kursejnë dhe të mbajnë në kontroll borxhet.

Por, teknokratët mund të jenë të aftë të përcaktojnë se sa dhimbje një vend duhet të durojë, si të bëhet niveli i borxhit i qëndrueshëm apo si të zgjidhet një krizë financiare. Por ata nuk janë aq të përshtatshëm të përcaktojnë se si dhimbja duhet të shpërndahet, nëse duhen rritur taksat apo shkurtuar shpenzimet në këtë apo atë grup. Këto janë çështje politike, jo teknokratike. Dhe ato nuk do të zhduken vetëm sepse një teknokrat është bërë kryeministër.

*The Economist, 16 nëntor 2011*

## Kriza europiane përtej financave

Të gjithë duket se po pyesin veten se cila do të jetë fatkeqësia e radhës që do t'i ndodhë Europës. Italia është në fokus, Spanja është gjithashtu një mundësi. Por, këto kriza tashmë janë në proces. Sipas gjyqimit të analistit George Friedman, kriza e ardhshme do të jetë politike, jo në kuptimin se cili politikan konvencional do të bëhet kryeministër, por në kuptimin më të thellë nëse elita politike e Europës mund ta mbajë pushtetin, ose nëse forca të reja politike do të dalin në pah për të riformtuar kështu krejtësisht peizazhin politik europian. Nëse kjo ndodh, do të përbëjë padyshim pasojën më të rëndësishme të krizës financiare europiane.

Deri tani kemi parë disa ndryshime politike në vendet në qendër të krizës. Qeveritë e kryeministrit Jorgos Papandreu në Greqi dhe Silvio Berlusconi në Itali tashmë kanë rënë. Edhe pse dorëheqjet e këtyre kryeministrave përfaqësojnë një ndryshim formal të qeverisë, ato ende nuk përfaqësojnë një ndryshim zyrtar të politikave. Në fakt, si Papandreu ashtu dhe Berlusconi u larguan me kusht që qeveritë vijuese të miratonin politikën e ashpra të propozuara gjatë mandateve të tyre përkatëse. Qeveritarët pro europianë dominojnë koalicionet që kanë zëvendësuar këta dy krerë. Ata vijnë nga klasa intelektualisht dhe emocionalisht thellësisht të angazhuar në idenë e Europës. Për ta Bashkimi European nuk është thjesht një mjet i dobishëm për arritjen e qëllimeve kombëtare. Përkundrazi, është një alternativë ndaj nacionalizmit dhe tmerreve që nacionalizmi ka sjellë në Europë. Ky është një vizion për një kontinent të afruar rreth një sipërmarrjeje të përbashkët - prosperitetit - që shmang rrezikun e një lufte europiane, krijon një projekt bashkëpunues ekonomik dhe e kthen Europën në vendin që i takon në zemër të sistemit ndërkombëtar politik. Çështja kyçe nuk është se si do të zgjidhet kriza financiare, por nëse projekti europian do të mbijetojë. Dhe kjo varet nëse elita pro europiane do të arrijë ta ruajë legjitimitetin e saj. Legjitimiteti nuk ka humbur, por po vihet në provë si kurrë më parë, dhe është e vështirë të kuptojmë se si elita e ruan atë.

Kriza europiane është një krizë sovraniteti, identiteti kulturor dhe legjitimiteti të elitës. Kriza financiare ka disa rezultate, të gjitha të këqija. Pavarësisht se cila zgjidhet, ndikimi në sistemin politik do të jetë jashtëzakonisht i madh.

George Friedman, Analist i Stratfor, 15 nëntor 2011

## Keq për ekonominë, mirë për studentët



**Kriza e eurozonës po ngjall interes në rritje për studimin e BE-së**

Ndërkohë që Europa ndryshon, ndryshon dhe mënyra se si studiohet ajo.

Kriza e eurozonës, rilindja e nacionalizmi, unilateralizmi në rritje dhe lidhjet gjithnjë e më të mëdha mes shteteve dhe institucioneve të mëdha financiare kanë ndryshuar rrënjësisht mënyrën se si Bashkimi European vepron.

Kjo ka bërë që profesorët e studimeve europiane të përshtatin mësimdhënien e tyre për tu shkuar pas ndryshimeve. Në të njëjtën kohë, sa më shumë Europa ndikon tek njerëzit në mbarë botën, aq më shumë rritet numri i studentëve në studime europiane.

Sipas Erik Jones, Drejtor i Institutit për Kërkime i Bolonjës, pjesë e Universitetit Johns Hopkins: "Lajmi i mirë është që kriza financiare ka nxitur që një komponent shpeshherë i neglizhuar i marrëdhënieve europiane - Ekonomia politike - të marrë vëmendje". Ai sugjeron se vështirësitë brenda eurozonës dhe ndikimi i tyre në nivel global kanë bërë që marrëdhëniet ekonomike dhe financiare mes vendeve të shihen si më të rëndësishme se sa historia diplomatike, dikur fokusi kryesor i studimeve europiane.

Duke rikonfirmuar rritjen e interesit për të studiuar zhvillimet në BE, Stephan Keukeleire, Drejtor i programit të masterit në studime europiane në Universitetin e Leuven-it dhe profesor në College of Europe në Belgjikë, flet gjithashtu për vështirësitë e studimit të kësaj fushe: "BE është e ndërlikuar për studentët, sepse ajo është e ndërlikuar për ne." Por prezenca e vazhdueshme në media e lajmeve mbi krizën e eurozonës ndihmon.

*European Voice, 20 tetor 2011*



## Kartolina nga BE-ja

### Zgjedhjet paraprake në Francë forcojnë demokracinë

Rreth 1.5 milionë qytetarë morën pjesë në zgjedhjet paraprake të Partisë Socialiste në Francë me 9 tetor 2011. Për herë të parë, edhe ata që nuk i përkasin partisë kishin të drejtë të votonin. Ndërsa François Hollande dhe Martine Aubry dolën fitimtarë, fituesja e vërtetë është vetë demokracia, shkruan *Libération*, një e përditshme e majtë: "T'u japë njerëzve pushtet të ri dhe të forcojë demokracinë ishin synimet e socialistëve për këto zgjedhje paraprake dhe këto kanë qenë njëkohësisht edhe ndër rezultatet më të rëndësishme. Kjo praktikë e re padyshim do të vendosë një precedent për partitë e tjera. Tani është koha për analiza të shpejta gjeografike dhe sociologjike për të parë se kush ka marrë pjesë. Por me gjithë suksesin e tyre, zgjedhjet paraprake të socialistëve kanë mobilizuar kryesisht shtresat intelektuale urbane të mesme dhe të larta. Shumë punë mbetet për tu bërë për të mobilizuar shtresa të tjera. Dhe kjo është pikërisht puna që i ka penguar socialistët të sigurojnë presidencën që nga viti 1995."

*Libération*, 10 tetor 2011

### Ndërkohë që disa mundohen të anëtarësohen, të tjerë përpiqen të largohen...

Mbi propozimin (e dështuar) për referendum mbi anëtarësinë e Britanisë së Madhe në Bashkimin Europian



Foto: plachineillustrations.blogspot.com

Pas mbledhjes së 100 mijë firmave dhe 5 orësh debat në Dhomën e Ulët, një propozim nga konservatorët për mbajtjen e një referendumi mbi anëtarësinë e Britanisë së Madhe në BE u hodh poshtë. Megjithëse propozimi u hodh poshtë bindshëm – 483 vota kundër dhe 111 pro – ai përbën në vetvete rebelimin më të madh deri më tani brenda Partisë Konservatore që kur Z. Cameron ka marrë detyrën në Downing Street.

Rebelimi i fundit në gjirin e konservatorëve mbi çështjen e integritimit europian datonte në vitin 1993, kur 41 deputetë e mundën kryeministrin John Major në lidhje me Traktatin e Mاستrihtit.

Megjithëse kjo ndodhi nuk e vuri seriozisht në rrezik qeverinë e Cameron, ajo sigurisht do të nxisë që Kryeministri të mundohet ta konkretizojë tashmë premtimin e tij për reformimin e rolit të Britanisë në BE dhe të përpiqet që një pjesë të kompetencave vendimmarrëse lidhur me ekonominë, zhvillimin dhe punësimin t'i "rikthejë në atdhe". Së fundmi, një debat i tillë, i zhvilluar në Britani për javë të tëra është tregues interesant i respektimit dhe dëgjimit të mendimit ndryshe brenda grupeve politike.

*BBC News*, 25 tetor 2011

### Berlin: Mbërrijnë Piratët!



Foto: www.bloomberg.com

E lindur në Suedi, por më e suksesshme në Berlin, Partia e Piratëve në Gjermani, u themelua pesë vjet më parë. Në zgjedhjet e shtatorit për shtetin (landin) e Berlinit, Piratët morën 8.9% të votave, duke siguruar 15 vende në legjislaturën e tij, mandati i parë për ta në nivel shtetëror. Në shkallë kombëtare, sondazhet tani sugjerojnë se Partia e Piratëve mund t'i nxjerrë jashtë loje Demokratët e Lirë, partnerët më të vegjël në koalicionin e Angela Merkel, duke u bërë kështu partia e pestë në Bundestag.

Po kush janë këta "piratë"? E drejtuar kryesisht nga ekspertë të informatikës, një nga parimet kryesore të Partisë së Piratëve është krijimi i një politike më transparente. Në zgjedhjet e Berlinit, Partia e Piratëve u paraqit si një parti sociale, duke bërë thirrje për pjesëmarrje më aktive të qytetarëve në jetën publike. Ajo vuri në jetë sistemin e "liquid feedbacks" (përkth. reagime të lëngshme), opinione të qytetarëve të mbledhura nëpërmjet forumeve online.

...vijon në faqen 8 >>

Sipas Piratëve, metroja duhet të jetë falas, por dhe interneti duhet të sigurohet gjithashtu falas, duke u bërë kështu një e mirë publike. Por ajo nuk është vetëm për hapjen e qytetarëve karshi një botë online. Partia e Piratëve është edhe për rritjen e ndërgjegjësimit mbi rreziqet që vijnë së bashku me internetin. Si formë e dëgjimit të vullnetit të qytetarëve, piratët mbështesin dhe idenë shtrirjes së mbajtjes së referendumeve për shumë çështje. Sa i takon barazisë gjinore, e kritikuar për dominim numerik të udhëheqësve burra, Partia e Piratëve pohon se në gjirin e saj nuk ekziston asnjë shqetësim lidhur me këtë çështje pasi, sipas tyre, barazia e vërtetë fillon pikërisht kur nuk merremi më me shifra e kuota të grave pjesëmarrëse.

Është e vështirë të thuash nëse “piratët” duhen marrë seriozisht. Në fakt kjo parti është cilësuar nga kritikët si jo profesioniste në politikë, një parti mbi një çështje të vetme e cila do të harrohet shumë shpejt. Çka është më e rëndë sipas kritikëve, duket se Partia e Piratëve nuk ka ndonjë program mbi politikën e jashtme dhe as mbi krizën e eurozonës. Por analistë të tjerë mendojnë se pikërisht një parti e tillë jo-konvencionale mund të joshë qytetarët e zhgënjyer nga politika tradicionale që aktualisht nuk votojnë apo edhe një pjesë të elektoratit të Partisë së Gjelbër (dikur partia anti-parti). Madje ka dhe nga ata që mendojnë se Britania e Madhe do jetë terreni i ardhshëm ku do të përhapen “piratët”.

*Stafi i EuroSpeak, nëntor 2011*

## Kundër frymës konservatore..

Deri para pak kohësh, do kishte qenë e pamendueshme që një politikan në Poloni ta pranonte hapur homoseksualitetin e tij. Kohët duket se kanë ndryshuar.

Me 10 nëntor 2011 u mandatuan dy deputetë homoseksualiteti i të cilëve njihet publikisht (njëri prej tyre është transeksual). Të dy bëjnë pjesë në lëvizjen Palikot, e cila në mënyrë surprizë u rendit e treta, duke marrë 10% në zgjedhjet e fundit në Poloni të cilat siç pritej, konfirmuan fitimtar koalicionin e Donald Tusk.

Lëvizja Palikot, e emërtuar sipas emrit të biznesmenit që e nisi, është një lëvizje anti-klerikale liberale, e përbërë kryesisht nga anëtarë me pak përvojë në politikë. Ajo po thyen disa tabu në Poloni, kryesisht duke këmbëngulur në ndarjen faktike mes shtetit dhe kishës në një vend kaq katolik.

Në të ardhmen, mendohet të paraqesë në parlament projekt-ligje për legalizimin e abortit, pakteve civile mes personave homoseksualë, dekriminalizimin e marijuanës, etj.

Edhe pse vetë drejtuesit e lëvizjes nuk presin që këto projektligje të aprovohen, ata gjykojnë se e rëndësishme është të ketë debat mbi të tilla çështje në një ambient konservator si ai polak.

## Viva la Revolution në Tiranë!



Foto: Stafi i EuroSpeak

Ndoshta me më pak bujë se në Poloni, por me shumë guxim dhe entuziazëm edhe në Tiranë disa të rinj po përpiqen të çmontojnë frymën konservatore. Aleanca Kundër Diskriminimit LGBT, një organizatë e re, ndër të paktat që me të vërtetë kanë arritur të mobilizojnë komunitetin LGBT në Shqipëri, hapi së fundmi Qendrën Komunitare LGBT. Ajo do të shërbejë si bazë ku komuniteti LGBT do të ketë mundësi të forcojë kapacitetet, të marrë pjesë në aktivitete argëtuese, të raportojë rreth rasteve të diskriminimit, të organizojë aksione ndërgjegjësuese, të rritet e të njihet.

*Stafi i EuroSpeak, nëntor 2011*



## Në pritje të aderimit...

### BE shikon nevojën e një strategjie kombëtare për energjinë në Bosnje - Hercegovinë

Ky ishte mesazhi i përcjellë nga Komisioneri i Energjisë, Günther Oettinger, në mbledhjen e katërt të nën-komitetit të energjisë midis BE-së dhe Bosnje-Hercegovinës, zhvilluar në Sarajevë. Sipas Z. Oettinger ekzistenca e një tregu të brendshëm sa më funksional dhe e një rrjeti transmetues ndërmjet shteteve do të mundësojë lëvizje të lirshme dhe të sigurt të energjisë elektrike dhe gazit në rajon. Ai përmendi propozimin e fundit të Komisionit për programin "Connect Europe", me një fokus të veçantë mbi energjinë. Në këtë kuadër, shmangia e bllokadës së 2009-ës që erdhi si pasojë e konfliktit Ruso-Ukrainas, është thelbësore.

Komisioneri përshëndeti hapat e parë drejt kësaj reforme ku konsumatorëve jo-shtëpiakë iu dha mundësia të zgjedhin midis furnitorëve të energjisë elektrike, dhe nënvizoi nevojën e reformave për hapjen e plotë të tregut brenda 2015-ës. Koordinimi efektiv dhe efikas ndërmjet dy subjekteve dhe shtetit do mundësojë shmangien e planifikimeve kontradiktore. Z. Oettinger e mbylli fjalimin e tij duke theksuar se një strategji e besueshme afatgjatë do të krijojë besimin e duhur tek investitorët e huaj. Me integrimin rajonal të Bosnje-Hercegovinës në tregun e energjisë, ju do të keni mundësinë të shisni energji elektrike përtej kufijve.

*Balkans, 16 nëntor 2011*

### Kryeministri Maqedonas reagon mbi kritikizmin e "ekzagjeruar" të BE-së

Sipas Komitetit për Mbrojtjen e Gazetarëve (Committee to Protect Journalists), Republika e Maqedonisë është kritikuar ashpër në Raportin e Progresit të Komisionit Europian të 2011-ës, sidomos për sa i përket lirisë së shtypit. Raporti i Progresit shpreh qartë se Maqedonia ka shumë për të bërë në rrugën drejt anëtarësimit europian. Me një gjuhë më të ashpër se zakonisht, raporti

shpreh se media vazhdon të jetë nën ndikimin dhe presionin e interesave politike dhe private. Një seri ngjarjesh si heqja e licencës së televizionit A1 dhe e gazetave të po të njëjtit grup mediatik, si dhe shkëmbimi i ofendimeve midis gazetarëve në stacione të tjera televizive duke krijuar fryma ekstremiste pro dhe kundër qeverisë, e kanë pozicionuar Maqedoninë tashmë në qendër të vëmendjes dhe kritikave të BE-së.

Në deklaratën e tij, Komisioneri për Zgjerimin e BE-së, Stefan Fule, theksoi se përpjekjet e vendit për të përmbushur reformat kanë rënë gjatë vitit të fundit.

Sipas BalkanInsight, reagimi i Kryeministrit Maqedonas, Nikola Gruevski, nuk ishte më pak i ashpër. Ai i karakterizoi fjalët e Z. Fule si pengesë për zgjidhjen e problemit kryesor që po pengon procesin e integritit të Maqedonisë, refuzimi i Greqisë për të njohur emrin kushtetues së vendit. Sipas tij, "strategjia për të ekzagjeruar" disa probleme që ekzistojnë në sistemin gjyqësor dhe administratën publike, duke përfshirë dhe "supozimin e mungesës së fjalës së lirë", bien ndesh me faktin se Maqedonia ka ndërmarrë reforma rrënjësore në këto sfera gjatë tre viteve të fundit. Por, Kryeministri mbylli deklaratën e tij duke thënë se qeveria e tij pranon rekomandimet e Komisionit dhe do vazhdojë punën për përmbushjen e tyre.

*Stafi i EuroSpeak, nëntor 2011*

### Komisioni Europian propozon hapjen e bisedimeve për liberalizimin e vizave me Kosovën



Foto: BalkanInsight

Raporti i Progresit i Komisionit Europian për Kosovën bën thirrje për hapjen e bisedimeve mbi lehtësimin e vizave në fund të këtij viti. Entuziazmin e lajmit e redukton deklarata e Komisionerit Europian për Zgjerim, Stefan Fule, ku theksohet arritja e kufizuar në axhendën e

reformave. Sipas tij, krimi i organizuar dhe korrupsioni mbeten sfidat kryesore, të ndjekur nga një nevojë e menjëhershme për reformë gjyqësore. Objektiva që mund të arrihen vetëm duke forcuar sundimin e ligjit në vend. Ai ka përshëndetur rezultatet pozitive që janë arritur në integrimin e Serbëve etnikë në jug të vendit, por ka shprehur shqetësimin e tij për situatën e tensionuar në veri. Reagimet e elitës politike mbi Raportin e Progresit ishin nga më të ndryshmet, ku qeveria e konsideronte si më të arririn deri më sot dhe opozita vinte në dyshim mbarëvajtjen e progresit.

*Stafi i EuroSpeak, nëntor 2011*

## **KE, mendim pozitiv për anëtarësimin e Kroacisë në 2013**

Por revista Forbes kritikon për anëtarësim të parakohshëm



Progresi Raporti i KE-së përshëndet avancimin e deritanishëm të Kroacisë në përmbushjen e reformave për procesin e integritit dhe shpreh opinion pozitiv për një anëtarësim të saj në 2013. Duke vlerësuar arritjet në sistemin gjyqësor dhe të të drejtave themelore, si edhe në drejtësi, liri dhe sidomos në siguri, Komisioni i bëri thirrje Zagrebit të përqendrohet në përmbushjen e të gjitha angazhimeve të tjera që ka marrë përsipër gjatë bisedimeve të anëtarësimit me Brukselin.

Afrimi i datës së anëtarësimit së Kroacisë ka shpalosur edhe analiza skeptike. Në një artikull të revistës prestigjioze Forbes shkruhet se, në qoftë se Kroacia nuk do të "ndërmarrë masa rrënjësore" që tani, BE-së do t'i shtohet mbi supe një ekonomi tjetër e paqëndrueshme, duke rënduar akoma më shumë problemet e tanishme.

Barra e një borxhi të rënduar do të vazhdojë të rritet për taksapaguesit europianë, rreziku për kreditë do jetë akoma më i lartë dhe presioni mbi tregjet amerikane do të jetë në rënie. Ekonomia Kroate është në rrezik dhe e karakterizuar nga korrupsioni, fakt që zhvendos pyetjen nga "si..." në "nëse..." Kroacia duhet të anëtarësohet në BE. Duke parë situatën aktuale, anëtarësimi i Kroacisë në BE do të jetë një tjetër detyrim që nuk mund ta përballojmë t'ia shtojmë ekspozimit tonë të vazhdueshëm me Greqinë. Ky anëtarësim mund të jetë fatal dhe për popullin Kroat, përfundon revista.

*Stafi i EuroSpeak, nëntor 2011*

## **Ndërkohë që perspektiva europiane venitet, Turqia shikon nga lindja**

Komisioni European e ka vlerësuar progresin e Turqisë gjatë vitit të fundit me nota negative, të karakterizuar me tensione të vazhdueshme midis Ankarasë dhe Qipros, si dhe me një oponencë të fortë nga Franca dhe Gjermania. Nga ana tjetër, kryeministri Turk, Tayyip Erdogan, ka deklaruar se Turqia është një shtet i fuqishëm dhe nuk do të pranojë të përulet dhe të lutet në dyert e BE-së.

Duke qenë në bisedime me Brukselin për anëtarësim që nga viti 2005 dhe duke aspiruar për tu bërë pjesë e NATO-s, gjatë viteve të fundit, politikat e shtetit Turk kanë pasur orientim perëndimor. Sidoqoftë, me progresin e kufizuar dhe venitjen e aspiratës Europiane, Turqia është ri-orientuar nga lindja, duke krijuar lidhje të forta me Lindjen e Mesme dhe Afrikën e Veriut. Studiuesi i Këshillit European për Marrëdhëniet me Jashtë, Daniel Korski, ngre shqetësimin se "akoma nuk ka pasur një diskutim serioz se si mund të zgjidhet çështja e një Turqie që, jo vetëm nuk ka një aspiratë aderimi të sigurtë, por që po kërcënon disa interesa thelbësore për disa Europianë".

Turqia është tashmë një vend demokratik me një ekonomi mjaft aktive, fakt që i ka dhënë popullsisë besim në vete. Sipas një studimi të kryer nga think-tank-u German Marshall Fund të publikuar në shtator, pjesa më e madhe e popullsisë Turke e konsideron Lindjen e Mesme si partner ekonomik më të sigurt se BE-ja.

*Reuters, 12 tetor 2011*

## Rregullorja e re e Shengenit, Shqipëria duhet të bëjë kujdes maksimal

Në një intervistë të dhënë për Gazetën "Shqip", Gledis Gjipali Drejtor Ekzekutiv i EMA-s sqaron se: Ndryshimet e propozuara për rregulloren e "Shengenit" janë një iniciativë e Komisionit European e bërë që prej nëntorit të vitit të kaluar me kalimin e Shqipërisë dhe Bosnjës në listën e bardhë të "Shengenit", që do të thotë lëvizje pa viza për një periudhë afatshkurtër. Me liberalizimin e regjimit të vizave, disa vende të BE-së kërkuan garanci të mëtejshme, pas rritjes së kërkesave për azil nga Serbia dhe Maqedonia. Këto garanci, të cilat mund të kthehen në legjislacion në fund të këtij viti, përfshijnë pezullimin e regjimit pa viza për qytetarët e vendeve problematike, në një mënyrë më të shpejtë e me më pak procedura se ato ekzistuese. Aktualisht, sipas propozimeve, një pezullim 6 - mujor do të vendoset kur verifikohet një prej tre rasteve. Në rastin e parë, kur ka një rritje të numrit të qytetarëve prej të paktën 50% nga 6-mujori i mëparshëm, të cilët qëndrojnë ilegalisht në vendin pjesë e hapësirës Shengen. Në rastin e dytë kur ka rritje prej të paktën 50% nga 6-mujori i mëparshëm, të numrit të qytetarëve të cilët aplikojnë për azil dhe dhënia e azilit është më pak se 3% (azilkërkuesit e rremë). Ndërsa në rastin e tretë kur ka rritje prej të paktën 50% nga 6-mujori i mëparshëm, të refuzimit të vendit të origjinës për ripranimin e të kthyerve ilegalë. Periudha e pezullimit mund të shtyhet deri në 9 muaj. Nëpërmjet këtyre ndryshimeve, tashmë BE-ja mund t'i përgjigjet shumë shpejt flukseve të menjëhershme të krijuara me verifikimin e rasteve të përmendura qoftë dhe vetëm në një vend anëtar të BE-së.

Shqipëria, si dhe vendet e tjera që përfituan lëvizje pa viza në hapësirën "Shengen" dy vitet e fundit, janë në monitorim të vazhdueshëm nga Komisioni European. Duhet pasur parasysh se për shkak të numrit të ulët të azilkërkuesve shqiptarë në vitet e fundit, do të mjaftonte një rritje prej disa dhjetëra azilkërkuesish, që pragu i 50% të kalohet lehtësisht. Është e rëndësishme të vlerësohen me kujdes të gjitha rastet e azilkërkuesve dhe të trajtohen problemet që shërbejnë si motivim i tyre dhe këto probleme nuk vijnë vetëm prej keqinformimit. Procesi i integritimit european është i mbushur me sfida të tilla dhe kërkohet adresim i tyre në vazhdimësi e jo vetëm kur arrijnë fazën akute, ku dhe trajtimi bëhet i vështirë."

*Stafi i EuroSpeak, nëntor 2011*

## Lëvizja Europiane feston 63 vjetorin e themelimit



Foto: Kongresi i Hagës, 25 tetor 1948

Më 25 tetor 1948, 63 vjet më parë u themelua Lëvizja Europiane (European Movement International). Presidenti i parë u caktua Duncan Sandy, ndërsa Léon Blum, Winston Churchill, Alcide De Gasperi dhe Henri Spaak u zgjodhën Kryetarë Nderi. Arritja e parë e madhe e Lëvizjes Europiane ishte krijimi i Këshillit të Europës në maj 1949, e më pas Kolegjit të Europës në Bryzh dhe Qendrës Europiane të Kulturës në Gjenevë. Origjina e Lëvizjes Europiane nis që në korrik 1947, në një kohë kur ideja e një Europe të Bashkuar nxitej nga **Winston Churchill** në formën e Lëvizjes së Bashkuar Europiane anglo-franceze. Në 25 tetor të vitit 1948, Kongresi i Hagës, kryesuar nga Winston Churchill, bëri thirrje për një bashkim politik, ekonomik dhe monetar të Europës. Kjo datë, është dhe lindja zyrtare e Lëvizjes Europiane. Që nga themelimi i saj, Lëvizja Europiane ka qenë e udhëhequr nga figura të shquara europiane publike të tilla si **Robert Schuman, Walter Hallstein, Enrique Baron Crespo, Valéry Giscard d'Estaing, Mario Soares, Jose Maria Gil-Robles** dhe **Pat Cox**.

Me kontributin e anëtarëve të saj entuziastë dhe me ndikim të madh në shoqëri, Lëvizja Europiane është një forcë shtytëse për promovimin e integritimit të mëtejshëm european dhe njihet gjerësisht si platforma më e rëndësishme e organizatave pro-europiane. Sot, anëtarësia e përbërë prej 42 Këshillave Kombëtarë dhe 32 Organizatave Ndërkombëtare, punon së bashku me shoqata europiane, parti politike, sipërmarrje, sindikata e lobistë. Aktualisht kryetari i Lëvizjes Europiane është Z. Pat Cox, ish-President i Parlamentit European dhe udhëheqës i fushatave të suksesshme në Irlandë për ratifikimin e Traktatit të Nisës e me pas atë të Lisbonës. Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA) është pjesë e Lëvizjes Europiane që prej vitit 2007 me themelimin e saj në Tiranë.

*Stafi i EuroSpeak, tetor 2011*



## Rikthimi i Historisë dhe Fundi i Ëndrrave



*Biblioteka e Studimeve Europiane dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare e Lëvizjes Europiane në Shqipëri, përkthyer dhe botuar nga shtëpia botuese "Dudaj", me mbështetjen e Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Shqipëri*

Në vazhden e kryeveprave të marrëdhënieve ndërkombëtare të sjella në shqip, Bibliotekës së Studimeve Europiane dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare

pranë EMA-s, si dhe librarive shqiptare u shtohet një ndër titujt kyç që ka frymëzuar debatet akademike në mbarë botën.

Gjatë pesë viteve të shkuara, bota liberale është shfaqur e përçarë dhe e shpërqendruar nga çështje të rëndësishme por jo vetëm. Robert Kagan, në librin "Rikthimi i Historisë dhe Fundi i Ëndrrave" paraqet në mënyrë të përkryer çështjet me të cilat përballen vendet me demokraci liberale, duke i sfiduar ato që të zgjedhin nëse duan të bëjnë historinë apo të lejojnë të tjerët ta bëjnë për to.

"Një vështrim elokuent, i fuqishëm, shqetësues, por në fund të fundit shpresëdhënës rreth balancës së re të pushtetit në botë – dhe rolit të duhur të Amerikës në të. Pikëpamjet e Kagan-it do të jenë pjesë thelbësore e debatit që do t'i japë formë politikës së jashtme të Presidentit tonë të ardhshëm."

*Richard Holbrooke, ish-ambasador i Shteteve të Bashkuara në OKB*


**Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA)** është një organizatë think tank e cila synon përmirësimin e cilësisë së debatit në lidhje me procesin e integritit europian. Lëvizja shërben si forum për shkëmbimin e pikëpamjeve mbi sfidat politike, ligjore, ekonomike, dhe sociale me të cilat përballlet Shqipëria në rrugën drejt integritit europian. Lëvizja, në mënyrë analitike, vlerëson fenomenet në funksion të promovimit të ideve dhe instrumenteve që përmirësojnë procesin e integritit europian. Studimet dhe dialogu mes aktorëve fokusohen në katër programe: Informimi dhe promovimi i vlerave europiane si dhe i procesit të integritit europian të Shqipërisë; Demokracia dhe mirëqeverisja; Aspektet ekonomike dhe sociale të integritit europian; Bashkëpunimi në nivel rajonal.

★ Tashmë EMA ka një faqe të re e më të pasuruar interneti. Nëpërmjet rubrikave të reja si Dosja e Integritit Europian dhe ajo e Liberalizimit të Vizave, faqja ofron një arkiv të besueshëm dhe lehtësisht të konsultueshëm mbi historinë e këtyre proceseve, dokumente e raporte zyrtare të institucioneve të BE-së dhe Qeverisë Shqiptare, si dhe analiza të aktorëve kryesorë jo-shtetërorë vendas dhe të huaj.

Për më shumë informacion, vizitoni:  
[www.em-al.org](http://www.em-al.org)

Të gjithë numrat e EuroSpeak i gjeni dhe në sitin e Lëvizjes Europiane në Shqipëri. Nëse dëshironi të merrni rregullisht buletin EuroSpeak nëpërmjet postës elektronike, na shkruani në: [info@em-al.org](mailto:info@em-al.org).

Për komente ose për të publikuar artikuj, mund të kontaktoni me kryeredaktoren, Blerta Hoxha, në adresën: [blerta.hoxha@em-al.org](mailto:blerta.hoxha@em-al.org)

 Realizimi i këtij buletini u mundësua me mbështetjen e Fondacionit Friedrich Ebert.